Atij që shkon te fatthënësi dhe e pyet për diçka, nuk do t’i pranohet namazi dyzet ditë

Një grua e Profetit tregon se Profeti ka thënë: "Atij që shkon te fatthënësi dhe e pyet për diçka, nuk do t’i pranohet namazi dyzet ditë."
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti në këtë hadith na njofton se kushdo që shkon te ndonjë fatthënës (ar. el arraf), që është një emër i përgjithshëm për falltarin, astrologun, atë që shikon në rërë e të ngjashëm, të cilët argumentojnë për njohjen e së fshehtës me anë të premisave që ata i përdorin, thjesht të pyeten për diçka nga çështjet e fshehta, bën që Allahu ta privojë atë nga shpërblimi i namazit për dyzet ditë, që është si dënim për këtë mëkat të madh.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5986